REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALLAKASTËR

KOMISIONI I HARTIMIT TË PLANIT TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Nr. 5544 **Prot.** ____ **Ballsh, më** 22.10.**2026**

PROJEKT-VENDIM

Nr. 64 **Datë** 22.10.**2026**

PËR

MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE NË BASHKINË MALLAKASTËR 2026-2031

-KËSHILLIT TË BASHKISË

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr. 10463, datë 22/09/2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve", Ligjin nr. 10431/2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", i ndryshuar, Ligjin nr 91/2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor",i ndryshuar, Ligjin nr. 107/2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, VKM nr. 418/2020, "Për Miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020–2035", VKM nr.418, datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim", VKM nr.608, datë 17.09.2014, "Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre", VKM nr.319, datë 31.05.2018, "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve", VKM nr. 402 datë 30.06.2021 "Për miratimin e Katalogut të Mbetjeve", VKM nr. 957 datë 19.12.2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike", VKM nr. 452, datë 11.07.2012, ndryshuar me VKM nr. 389, datë 27.6.2018, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 452, datë 11.07.2012 të Këshillit të Ministrave", VKM nr. 575 datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte", të urdhrit nr. 193, datë 12.05.2026 "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Planit Vendor për të Menaxhimit të Mbetjeve në Bashkinë Mallakastër", në bazë të shkresës nr.307 prot, datë 25.09.2026 Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve (AKEM) është shprehur se parimisht është dakord me Planin Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2026-2031 dhe Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM), si dhe Deklaratës Mjedisore me nr 3924/8 prot, datë 05.10.2026,

PROPOZOJ:

1. Miratimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve në Bashkinë Mallakastër 2026-2031, sipas dokumentit bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij projekt-vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe e Çështjeve Sociale, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, si dhe çdo strukturë tjetër e angazhuar në administrimin e infrastrukturës dhe shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve.

3. Ky Projekt-vendim shoqërohet me relacion shpjegues.

KRYETAR

Qerim Ismailaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALLAKASTËR
KOMISIONI

Nr. 5544 Prot.

Ballsh, më 22.10 . 2026

MIRATOHET
Kryetar
Qerim Ismailaj

RELACION SHPJEGUES MBI PROJEKT-VENDIMIN "PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE NË BASHKINË MALLAKASTËR 2026-2031"

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 , "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit nr. 57/2025 ,"Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve", si dhe të urdhërit nr. 193 ,datë 12.05.2026 "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve në Bashkinë Mallakstër", të kryetarit të Bashkisë Mallakastër, si dhe në përmbushjen e objektivave kombëtare në fushën e menaxhimit të mbetjeve dhe përmbushjen e standarteve që burojnë nga procesi i integrimit evropian, Bashkia Mallakastër ka inicuar projekt – vendimin "Për miratimin e planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve në Bashkinë Mallakastër 2026-2031". Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore në ushtrimin e funksioneve dhe të kompetencave të tyre mund të ndërmarrin nisma me interes publik në territorin nën juridiksionin e tyre për çdo çështje që nuk u ndalohet me ligj.

Ky relacion shpjegues për hartimin e një Plani të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve shërben për të argumentuar nevojën e këtij dokumenti dhe për të përcaktuar objektivat, masat dhe buxhetin për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Qëllimi kryesor i këtij plani është :

- Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbetjeve në përputhje me kërkesat ligjore.
- Harmonizimin dhe forcimin e kuadrit institucional.
- Sigurimin e financimit të qëndrueshëm për shërbimet e pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve.
- Rritjen e ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve.
- Përmirësimin e instrumentave ligjore, institucionale dhe financiare.

Fusha e veprimit e planit përfshin të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Mallakastër dhe mbulon :

- Pastrimin e rrugëve dhe hapësirave publike.
- Grumbullimin dhe transportin e mbetjeve.
- Trajtimin dhe depozitimin e tyre.
- Menaxhimin e mbetjeve shtëpiake , organike, inerte, elektronike dhe të riciklueshme.

Dokumenti mbështetet në analizën e gjendjes aktuale të shërbimit, kapaciteteve ekzistuese operacionale, tendencave të rritjes së gjenerimit të mbetjeve, si dhe nevojës për rritjen e efikasitetit në përdorimin e burimeve publike dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar ndaj qytetarëve.

Bashkia Mallakastër do të fokusohet në një grup objektivash strategjikë të cilët përfaqësojnë drejtimet kryesore të zhvillimit të sektorit të menaxhimit të mbetjeve për periudhën 2026-2031, të cilat ndahen në :

1. Përmirësimi dhe zgjerimi i mbulimit të menaxhimit të mbetjeve në të gjithë territorin e bashkisë.
2. Reduktimi i sasisë së mbetjeve që depozitohen dhe nxitja e praktikave të ekonomisë qarkulluese.
3. Krijimi i kushteve për ndarjen e mbetjeve në burim dhe rritjen e riciklimit.
4. Forcimi i qëndrueshmërisë financiare dhe institucionale të sistemit të menaxhimit të mbetjeve.
5. Rritja e ndërgjegjësimit publik dhe pjesëmarrjes së komunitetit.

Miratimi i këtij plani përfaqëson një instrument të rëndësishëm për një zhvillim të qëndrueshëm të territorit. Përmes përmirësimit të shërbimeve, rritjes së riciklimit, forcimit të infrastrukturës dhe ndërgjegjësimit të qytetarëve, ai synon të krijojë një mjedis më të pastër, më të sigurtë dhe më të qëndrueshëm për komunitetin.

Hartimi i këtij plani ka kaluar në disa etapa :

1. Grupi i punës i Bashkisë hartoi Draft-Planin Lokal në bashkëpunim me konsulentët.
2. Në datën 22.06.2026 në orën 10:00 në Njësinë Administrative Fratar u realizua dëgjesa e parë publike e protokolluar në lidhje me këtë plan. Gjithashtu në orën 13:00 u realizua
3. Me shkresën Nr.3287 Prot. të datës 26.06.2026 u bë përcjellja e Planit Vendor dhe Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor për vijimin e procedurës sipas Ligjit Nr.91/2013 drejt Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Drejtorisë përgjegjëse për Vlerësimin Strategjik Mjedisor. Përgjigje për këtë shkresë ka ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme Regullatore

dhe Përputhshmërisë me shkresën Nr.3788/1 Prot. datë 13.07.2026, protokolluar në Bashkinë Mallakastër me Nr.3287/2 Prot. datë 15.07.2026 ku në pikën e parë kërkohet:

Njoftimi i ministrisë nga autoriteti propozues. Ky njoftim është kryer nga ana jonë me shkresën nr.3287/1 Prot. datë 08.07.2026 drejtuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit , Ministrit Z.Sofjan Jaupaj .

4. Përgjigje ka ardhur me shkresën nr. 3924/2 prot. Datë 16.07.2026, protokolluar në institucionin tonë 3287/3 prot, datë 17.07.2026 në të cilën kërkohet që procedura e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të kaloj në disa faza të tjera.
5. Në vazhdimësi me shkresën nr.3835 prot, datë 22.07.2026 është bërë kërkesa për deklaratë Mjedisore sipas përcaktimeve të pikës 4 ,neni 12 të ligjit Nr.91/2013 "Për vlerësimin strategjik mjedisor".
6. Me shkresën nr 3835/2 prot, datë 02.09.2026 është plotësuar kërkesa për Deklaratë Mjedisore me 3 pika të tjera sipas shkresës nr. 3924/4 prot, datë 28.07.2026 nga Ministria e Mjedisit .

1) Përmbledhja në gjuhë joteknike e raportit përfundimtar të VSM-së.
2) Urdhër – Shpenzimi për faturën e tarifës së shërbimit për shqyrtimin e kërkesës nga ministria.
3) Procesverbali nr. 3997/2 prot, datë 24.08.2026 për dëgjesën publike të realizuar për procesin e vlerësimit strategjik mjedisor.

7. Me shkresën nr. 3835/3 prot. Datë 15.09.2026 u bë një plotësim i planit vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2026-2031 dhe Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM).
8. Me Shkresën nr.307 prot, datë 25.09.2026 Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve (AKEM) është shprehur se parimisht është dakord me Planin Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2026-2031 dhe Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM).
9. Deklarata Mjedisore ka ardhur me shkresën nr 3924/8 prot datë 5.10.2026 nga Ministria e Mjedisit.

Për sa më sipër, kërkohet nga Këshilli Bashkiak shqyrtimi dhe miratimi i Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve në Bashkinë Mallakastër 2026-2031.

GRUPI I PUNËS

E.Sinanaj

B.Prifti

P.Isufaj